



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:297959
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06444048

C.nr.820/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike të paditësve A.K nga fshati Retijë, A.D nga Rahoveci, A.K1 nga Prizreni, A.E nga fshati Piranë, Komuna Prizren dhe A.K2 nga fshati Retijë, Komuna Rahovec, të cilët i përfaqëson Av. D.M nga Prizreni rr. ”....”, kundër të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë, vlera e kontestit 576.00 euro, jashtë seance, më datë 13.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësve A.K nga fshati Retijë, A.D nga Rahoveci, A.K1 nga Prizreni, A.E nga fshati Piranë, Komuna Prizren dhe A.K2 nga fshati Retijë, Komuna Rahovec, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësit A.K nga fshati Retijë, A.D nga Rahoveci, A.K1 nga Prizreni, A.E nga fshati Piranë, Komuna Prizren dhe A.K2 nga fshati Retijë, Komuna Rahovec, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, ka ushtruar padinë kundër të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit në punë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve Av. D.M nga Prizreni me parashtresë të veçantë të datës 08.11.2024, e ka tërhequr padinë.

Andaj, kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësve është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.820/2024, më 13.11.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.